

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Administrator WAN	Reparti Ushtarak nr. 3005, Kuçovë, në Forcën Ajrore	Kuçovë	E pacaktuar	Me dosje	-	11.02.2022	25.02.2022

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	“Administrator WAN”
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr. 3005, Kuçovë, Forca Ajrore
4. Vendi:	Kuçovë
5. Paga:	Trajtohet me pagë sipas VKM nr. 202, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, Lidhja nr. II, II/I me Klasën IX, (35.400). Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr.1706, datë 13.10.20215 “Për shtesat mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin”, I/a, II/f, (5340).
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	11.02.2022
8. Data e mbylljes së aplikimit:	25.02.2022
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	<p>Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesën personale; • Formularin e aplikimit; • Fotokopje të kartës së identitetit; • Dëftesën e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin; • Diplomë e arsimit të lartë/listë notash të noterizuar me origjinalin;

- Fotokopje e patentës nëse ka;
- Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Raport mjekësor;
- Fotografii me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 copë;
- Dëshmi penalteti;
- Vërtetim gjykata;
- Vërtetim prokurorie;
- Librezë pune;
- Jetëshkrim (CV);
- Formulari i vetëdeklarimit;

11. Kërkesa të përgjithshme të vendit të punës:

- a) Të ketë shtetësi shqiptare;
- b) Të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) Të plotësojë kriteret për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin e përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- e) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- f) Të mos jetë i denuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- g) Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil II;
- b. Arsimi : I mesëm ose i lartë;
- c. Kualifikimi: Të ketë experience dhe përvojë pune në fushën e ndërlidhjes;
- d. Trajnimi: Kurse dhe kualifikime te ndryshme në fushën e ndërlidhjes;
- e. Eksperienca në Punë: 3 vjet;
- f. Gjuha e huaj: STANAG 1/1/1/1;
- g. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të nevojshme për përdorimin e kompjuterit si dhe experience të mëparshme në fushën e ndërlidhjes;
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë; Konfidencial

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore:

- a) Organizimi dhe koordinimi i punës për ruajtjen mirëmbajtjen e teknikës në përdorim, rrjetit kompjuterik të klasifikuar, kryerjen e profilaktikave të aparaturave.
- b) Monitoron gjendjen e teknikës në përdorim, menaxhon dhe evidenton problemet e mundëshme që dalin.
- c) Rekomandon dhe i propozon komandantit të skuadrës/togës/specialistit për ndërlidhjen mbi ecurinë, gjendjen e teknikës në përdorim.
- d) Ndjek në vazhdimësi kompletimin me bazë material të nevojshme të sistemit kompjuterik dhe instalimeve elektrike.

- e) Harton dhe plotëson të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për cdo kompjuter punimet e kryera dhe problemet e dala.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për zbatimin e të gjitha kërkesave rregulloreve dhe manualeve që përdoren për mbajtjen në gadishmëri të mjeteve dhe pajisjeve të ndërithjes.

12. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I PERSONELIT

NËNKOLONEL VLADIMIR JAUPI